



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit

SP-094

Prishtinë, më 2, 9 dhe 10 mars 2017

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2, 9 DHE 10 MARS 2017

Seancën e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, i ndihmuar nga nënkryetari Sabri Hamiti.

Nënkryetari i hapi punimet e kësaj seance plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Pal Lekaj, Abdyl Ymeri, Nuredin Ibishi, Blerta Deliu-Kodra, Besa Gaxheri, Mexhide Mjaku-Topalli, Vjosa Osmani, Muhamet Mustafa, Nait Hasani dhe ministri Enver Hoxhaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Deputetët e grupeve parlamentare LVV, AAK dhe "Nisma", në shenjë pakënaqësie për ndalimin e kryetarit të AAK-së, z. Ramush Haradinaj, nga autoritetet franceze, sipas fletarrestimit të lëshuar nga autoritetet serbe nëpërmjet Interpolit, i lëshuan punimet e Kuvendit.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me riformatimin dhe ristrukturimin e dialogut Kosovë-Serbi.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i parashtroi pyetje ministres për Dialog, Edita Tahiri, në lidhje me çështjen e të pagjeturve.

Ministrja Edita Tahiri nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me pensionet e familjeve të dëshmorëve.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Hajdar Beqa i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, në lidhje me lehtësimin e procedurave për fitimin e shtetësisë së Kosovës për shqiptarët e Luginës së Preshevës të vendosur në Kosovë.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Salihe Mustafa i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me zbatimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Ministri Avdullah Hoti iu përgjigj pyetjes së deputetes.

* * *

Në vazhdim, kryetari i Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me pesë pika shtesë.

Deputetja Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit për Legjislacion, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Nait Hasani, propozoi që në rend të ditës të hyjë për diskutim çështja e ndryshim-plotësimit të Ligjit për Gjykatën Speciale.

Pastaj, kryesuesi pas deklarimeve të kryetarëve të komisioneve parlamentare, i hodhi në votim propozimet e lartshënuara një nga një.

Për propozimin e deputetit Naser Osmani, rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi vendosi që rendi i ditës të plotësohet edhe me këto pika shpesh:

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave,
- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar,
- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Protokollit Financiar mes Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS.
- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK-në, Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe
- Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetes Selvije Halimi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi vendosi që rendi i ditës të plotësohet edhe me këtë pikë shpesh:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Nait Hasani.

Kryesuesi konstatoi se në votim kanë marrë pjesë 54 deputetë dhe nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Kryesuesi, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të PDK-së dhe të LDK-së (grupet parlamentare LVV, AAK dhe “Nisma” më herët e kishin lëshuar seancën) i ndërpreu punimet e seancës së sotme në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të autoriteteve franceze për vazhdimin e ndalimit të kryetarit të AAK-së, sipas fletarrestimit të lëshuar nga autoritetet serbe nëpërmjet Interpolit.

E enjte, 9 mars 2017

Vazhdimi i seancës plenare

(Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit me kryetarët dhe grupet parlamentare në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2017, me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të AAK-së, zotit Pal Lekaj, ka vendosur që në seancën e sotme të procedohet votimi i Propozim-rezolutës lidhur me mbajtjen e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

Kryesuesi dha pauzë gjysmë ore dhe kërkoi nga krupet parlamentare që ta harmonizojnë tekstin e deklaratës.

Pas pauzës, kryesuesi e ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së, z. Pal Lekaj, që ta paraqesë tekstin e propozim-rezolutës të harmonizuar ndërmjet grupeve parlamentare: PDK, LDK, LVV, AAK dhe “Nisma”.

Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, z. Pal Lekaj, e paraqiti tekstin e harmonizuar të propozim-rezolutës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozim-rezolutën. Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----78,

Kundër ----- 1

(ndërkohë deputetja Mirjeta Kalludra ka deklaruar se votimi i saj “kundër” ishte gabim teknik dhe e deklaroi votën “për”)

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi këtë:

REZOLUTË

Lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë.

1. Lirimi pa kushte i ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, të ndodhë sa më shpejt dhe të konsiderohet detyrë primare shtetërore.
2. Të pezullohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë deri në lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga BE-ja që ta detyrojë Serbinë t'i anulojë të gjitha aktakuzat dhe fletarrestimet e lëshuara nga Serbia nëpërmjet Interpolit për shtetasit e Republikës së Kosovës.

4. Qeveria dhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës obligohen t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme, në mënyrë që t'i informojnë të gjitha instancat ndërkombëtare se "...e refuzojnë juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e ish-Jugosllavisë" dhe konform kësaj të kërkojnë lirim të ish-kryeministrit të Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Kryesuesi nuk e procedoi këtë pikë, ngase nuk ishte i pranishëm ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, për ta paraqitur dhe arsyetuar projektligjin.

5. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projekt-kodin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projekt-kodin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projekt-kodit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projekt-kod.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim rreth këtij projekt-kodi.

Lidhur me Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur diskutuan: Armend Zemaj, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe në emër të GP të LDK-së, Agim Aliu, në emër të GP të PDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, si dhe deputetët Glauk Konjufca e Faton Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas kryesuesi e hodhi në votim projekt-kodin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	67,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur.

2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projekt-kodin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, z. Muhamet Mustafa, që ta paraqesë raportin e komisionit.

Deputeti Mustafa, në emër të komisionit, propozoi që Kuvendi të mos e miratojë këtë projektligj të propozuar nga deputeti Shaip Muja, i mbështetur edhe nga pesë deputetë të tjerë, ngase është formuar një grup gjithëpërfshirës, i përbërë nga Komisioni Funkcional, KPMM, ministria e linjës dhe Qeveria për hartimin e një ligji të ri.

Pastaj, kryetari e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet diskutuan: Shaip Muja në emër të propozuesit të projektligjit, Sala Berisha-Shala në emër të GP të PDK-së, Blerim Grainca, në emër të GP të LDK-së, si dhe deputetët Shukri Buja, Besim Beqaj, Qerim Bajrami, Abdyl Ymeri, Armend Zemaj dhe Enver Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim për këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë diskutuan: Selviqe Halimi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Agim Aliu, në emër të GP të PDK-së, Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, Enver Hoti, në emër të GP "Nisma", si dhe deputetët Albulena Haxhiu, Melihate Tërmerkoll, Njomza Emmini, Vjosa Osmani, Rexhep Selimi dhe Emilija Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve për këtë projektligj konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimarrje.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim për këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore diskutuan: Selvije Halimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së, Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve për këtë projektligj konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimarrje.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për noterinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim për këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për noterinë diskutuan: Agim Aliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Abdyl Ymeri, në emër të GP të PDK-së, Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve për këtë projektligj konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimarrje.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim për këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik diskutuan: Selville Halimi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Agim Aliu, në emër të GP të PDK-së, Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, si dhe deputetët Shukri Buja, Ismajl Kurteshi dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve për këtë projektligj konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimarrje.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës diskutuan: Sali Salihu, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Shqipëri, në emër të GP të PDK-së, Adem Salihaj, në emër të GP të LDK-së,

Salih Salihu, në emër të GP të LVV-së, Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së dhe Qerim Bajrami, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve për këtë projektligj konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimarrje.

14. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi fjalën ia dha z. Naser Osmani, kryetar i Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa.

Meqë nuk pati diskutues të tjerë, kryesuesi konstatoi se ky projektligj do të hidhet në votim kur të ketë kuorum të nevojshëm.

15. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Financave, z. Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për këtë projektligj diskutoi edhe deputeti Driton Çausi.

Kryesuesi nuk e hodhi në votim këtë projektligj, ngase nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

16. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-154 për ratifikimin e Protokollit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Kryesuesi nuk e hodhi në votim këtë projektligj, ngase nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional për Legjislacion ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit Funksional ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputeti Armend Zemaj e paraqiti dhe e arsyetoi raportin dhe kërkoi nga deputetët që ta miratojnë raportin me rekomandime.

Lidhur me këtë raport diskutuan: Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së dhe Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi nuk e hodhi në votim këtë raport, ngase nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

17. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-155 për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK-në, Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Kryesuesi nuk e hodhi në votim këtë projektligj, ngase nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

* * *

E premte, 10 mars 2017

Vazhdimi i seancës plenare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në seancën e sotme do të procedohet vetëm me votimin e pikave që janë shqyrtuar në seancën e djeshme, por për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm nuk janë proceduar për votim.

6. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 34,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

7. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----72,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi i Projektligjit për noterinë

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 73,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për noterinë.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për-----71,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Votimi i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 74,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONal dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Në projektligj ishin propozuar 15 amendamente nga Komisioni FunkSIONal.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një. Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 72,
Kundër ----- 1,
Abstenime -----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-130 për shërbime.

13. Votimi i raportit të Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

14. Votimi i Projektligjit nr. 05/L-152 për ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.
Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----81,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-152 për ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

15. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.
Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 81,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar.

16. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Protokollit Financiar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----83,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji për ratifikimin e Protokollit Financiar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS.

17. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK-në, Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryesuesi e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 80,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK-në, Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit Funksional, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin propozuar 2 amendamente nga Komisioni Funksional.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një.
Kuvendi i miratoi amendamentet 1 dhe 2.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.
Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----69,
Kundër -----10,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Nënkryetarja i Komisionit Funksional, znj. Selville Halimi, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Deputeti Nait Hasani e dha sqarimin për amendamentin e propozuar në këtë projektligj.

Në këtë projektligj ishin propozuar 14 amendamente nga Komisioni Funksional dhe 1 amendament nga deputeti Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kryesuesi e hodhi në votim amendamentin nr. 1 të propozuar nga deputeti Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kryesuesi konstatoi se nuk kanë votuar numër i mjaftueshëm i deputetëve (61) që nevojitet për vendimmarrje. Ai nuk procedoi me votimin e amendamenteve të tjera, pa u votuar amendamenti i parë.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës në orën 11:11 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit

Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale